



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:204253  
Datë: 06.08.2024  
Numri i dokumentit: 06020854

CA.nr.8001/24

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nehat Idrizi, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi- Alaj dhe Besnik Bislimaj, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të propozuesit S. Sh., nga Gj..., rr. ..., p.nr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Avdi Rizvanolli, avokat në Gjakovë, kundër kundërshtarit të sigurimit S. G., nga Gj., rr., p.nr, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Genc Juniku, avokat nga Gjakova, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit të masës së sigurimit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1622/23, të datës 14.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 30.07.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të propozuesit të masës së sigurimit S. Sh., nga Gj..., rr. ..., p.nr, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1622/23, i datës 14.05.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar C.nr.1622/23, të datës 14.05.2024, në pikën një të dispozitivit të saj, e ka refuzuar si të pa bazuar në ligj propozimin për caktimin e masës së sigurisë të propozuesit S. Sh., nga Gj..., rr. ..., p.nr, me të cilin ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë me të cilën i ndalohet kundërshtarit të sigurimit S. G., nga Gj..., që ta tjetërsoj, bart në pronësi, ta dorëzoj në posedim të personave të tretë paluajtshmerinë, përkatësisht pjesën ideale të paluajtshmerisë ..., Zona Kadastrale ..., jashtë qytet, lloji i shfrytëzimit- tokë ndërtimore, shfrytëzimi aktual oborr, në sipërfaqe prej ...m2, shtëpi-ndërtesë, në sipërfaqe prej ...m2, dhe arë në sipërfaqe prej ...m2, në pjesë të pronës .... Ndërsa, në pikën dy, secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi ka paraqitur ankesë propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit, të merr vendim që ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e atakuar ta ndryshojë, duke e aprovuar kërkesën e palës propozuese, apo ta prish vendimin dhe çështjen të ia kthej Gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur kundër propozuesi, me kërkesë që të refuzohet ankesa e propozuesit si e pa bazuar, ndërsa vendimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

#### Ankesa është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurisë me datë 26.09.2023, ndaj kundërshtarit të sigurimit. Me datë 02.10.2023, i padituri- kundër propozuesi, ka paraqitur përgjigje lidhur me propozimin për caktimin e masës së sigurisë, duke e kundërshtuar në tërësi te njëjtën si të pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së seancës dëgjimore, administrimit dhe vlerësimit të provave materiale, certifikatën e pronësisë, të datës ..., kontratën e shitblerjes të datës ....., si dhe konstatimet e datës ....., ekspertizën gjeodezike të datës 01.11.2023, pastaj ka bërë dëgjimin e ekspertit gjeodet Sehar Omega, dëgjimin e dëshmitarit F. B., si dhe ka dëgjuar propozuesin S. Sh., në cilësi të palës, ku edhe ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata ka theksuar se propozimi i propozuesit për caktimin e masës së sigurimit është i pa bazuar, për shkak se i njëjti në këtë fazë të procedurës nuk ka ofruar prova materiale apo personale të mjaftueshme që do të bënin të besueshëm të drejtën subjektive të tij, nga neni 297, par.1, pika a), të LPK-së, si dhe nuk ka ofruar prova të mjaftueshme të cilat do të vërtetonin edhe kushtin tjetër të paraparë me nenin 297.1, pika b), ekzistimin e rrezikut real se pa caktimin e masës së propozuar, propozuesit do të i pamundësohej apo vështirësohej realizimi i kërkesës. Se propozuesi në këtë fazë të procedurës nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e të drejtës së tij subjektive për faktin se nga provat në shkresa të lëndës u vërtetua ekzistimi i një kontrate të shitblerjes por nuk është arritur të bëhet i besueshëm pretendimi se një kontratë e tillë është përmbushur në tërësi nga ndergjyqjesit për tu kërkuar vërtetimi i së drejtës së pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes së paluajtshmerisë, kështu që nuk mjafton vetëm të kërkohej vendosja e sigurimit të kërkesës, pa ofruar prova bindëse në lidhje me kërkesën apo të drejtën subjektive të saj.

Për mënyrën e vendosjes, Gjykata në shkallë të parë, ka vendosur në pajtim me nenin 297.1, pika a) dhe b), të LPK-së, nenin 299, 304.3, 279.1, pika b), 450, 463 par. 1 dhe 2, nenin 387.1, pika (1), e lidhur me nenin 142.5, po ashtu të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare, në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore me pretendimin se dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyet e tij, ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktvendimit është i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Sipas dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, neni 297, paragrafi 1 pika a) dhe b), përcaktohet në mënyrë të qartë se: masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtën subjektive të tij, në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjerave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit, por që këto dy kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Me nenin 304, paragraf 3 të LPK-së, përcaktohet se: “Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës së sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtuara në propozim. Propozuesi i sigurimit ka për detyrë po që se ka mundësi, që mjetet provuese t’ia bashkëngjitë propozimit”.

Në rastin konkret Gjykata e Apelit, vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë për mënyrën e vendosjes është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi propozuesi kërkesën e tij për caktimin e masës së sigurisë nuk e ka bërë të besueshëm, ashtu siç edhe Gjykata në shkallë të parë ka konstatuar se nga provat në shkresa të lëndës, përveç se u vërtetua ekzistimi i një kontrate të shitblerjes, mirëpo nuk është arritur të bëhet i besueshëm pretendimi se një kontratë e tillë është përmbushur në tërësi nga ndergjyqjesit për tu kërkuar vërtetimi i së drejtës së pronësisë në bazë të kontratës së shitblerjes së paluajtshmerisë, kështu që nuk mjafton vetëm të kërkohet vendosja e sigurimit të kërkesës, pa ofruar prova bindëse në lidhje me kërkesën apo të drejtën subjektive të saj, të cilin qëndrim si të bazuar në ligj, e aprovon edhe kjo gjykatë.

Përveç kësaj, caktimi i masës së sigurimit të kërkesëpadisë, ligjërisht ka karakter të përkohshëm, pasi që gjykata e shkallës së parë, qoftë sipas detyrës zyrtare apo propozimit të palëve, në çdo rast gjatë procedurës, nuk ka pengesa ligjore që masën e sigurimit të kërkesëpadisë, ta revokoj në qoftë se e njëjta në ndërkohë vlerëson se kanë ndryshuar, përkatësisht pushuar rrethanat për të cilat është caktuar apo të njëjtën ta zëvendësoj duke shqiptuar lloj tjetër të masës, e cila sa me pak do te prekte të drejtat dhe interesat e të dyja palëve në procedurë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar të gjitha pretendimet e tjera ankimore të autorizuarit të propozuesit, por nuk ka gjetur se ekzistojnë rrethana apo shkelje të tilla që do të ndikonin për nxjerrjen e një vendimi ndryshe, për çka edhe vendosi si dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- NË PRISHTINË**

CA.nr.8001/24, me datë 30.07.2024

Kryetari i kolegjit  
Nehat Idrizi d.v

---